

Z. Besmir Lesha ka lindur në qytetin e Shkodrës, më datë 18 Korrik 1986.

Ka kryer studimet e larta në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik, në degën “Administrim Biznes” nga viti 2005-2010.

Gjatë periudhës 2006-2007 ka kryer detyrën e Përgjegjës të grupit, në Kooperatën Energjetike Shqiptare. Në harkun kohor 2008-2023, ka një përvojë rreth 15 vjeçare në menaxhimin e bizneseve në sektorin privat, në rolin e menaxherit, duke krijuar përvojën dhe ekperiencën e duhur në drejtimin institucional dhe menaxherial.

Prej Janarit 2023, Z. Lesha, drejton Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.